



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 160 Prot.

Tiranë, më 27.06.2017

Lënda : Për rishpalljen për herë të tretë të thirrjeve për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga anëtarët e personelit akademik për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ë Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Drejtuar: Znj.Kseanela Sotirofski
Rektore e Universitetit “Aleksandër Moisiu”
Z.Andon Kume
Dekan i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit “Aleksandër Moisiu”

Z.Adem Bekteshi
Rektor i Universitetit “Luigj Gurakuqi”
Z.Roland Dodani
Dekan i Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”

Z.Fatos Tarifa
Rektor i Universitetit të New York-ut në Tiranë
Znj.Enila Cenko
Dekane e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të New York-ut

Z. Lush Përpali
Rektor i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University”
Z. Naim Mëçalla
Dekan i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University”

Z. Lavdosh Zaho
Rektor i SHLP “Tirana Business University”

Z. Endri Papajorgji
Dekan i SHLP "Tirana Business University"

Z. Irakli Koçollari
Rektor i Akademisë Profesionale të Biznesit
Z. Simon Gega
Dekan i Akademisë Profesionale të Biznesit

Z. Nexhmedin Dumani
Rektor i Shkollës së Lartë Private Mesdhetare të Shqipërisë
Z. Përparim Kabo
Dekan i Shkollës së Lartë Private Mesdhetare të Shqipërisë

Të nderuar,

Ashtu siç edhe ju jeni në dijeni nga korrespondencat e mëparshme, në cilësinë e organit përgjegjës për thirrjen e mbledhjes së posaçme të drejtuesve për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatëve për anëtarë të KLGJ dhe KLP nga trupa e pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës, në zbatim të neneve 48 dhe 146 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm, me anë të vendimit nr. 2, datë 13.03.2017, ka vendosur të pezullojë procedurën e thirrjes së Mbledhjes së Posaçme të Drejtuesve të Institucioneve për Përzgjedhjen Përfundimtare të kandidatëve, sipas përcaktimeve të neneve 48 dhe 146 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", deri në dërgimin e kandidaturave të reja që kanë shprehur interesin për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nga trupa e pedagogëve.

Në kushtet kur:

- Në përfundim të procesit të aplikimeve, verifikimit dhe votimit nga asambltë e personelit akademik të pedagogëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezultoi mosplotësimi i numrit minimal të kandidaturave të parashikuara nga nenet 53 dhe 151 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë";
- Rishpalljet e mëparshme të thirrjes nga institucionet e arsimit të lartë, të akredituara sipas legjislacionit në fuqi, për të plotësuar numrin e minimal të kandidaturave të parashikuara në dispozitat e sipërpërmendura të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë";
- Pas votimit të anëtarëve të organeve për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, rezultoi se dy kandidatë pedagogë që kanë aplikuar për KLGJ dhe KLP, janë zgjedhur anëtarë të organeve të rivlerësimit,

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Shqipërisë po ju drejtohet, përsëri, për rishpalljen për herë të tretë të thirrjeve për paraqitjen e shprehjeve të interesit nga anëtarët e personelit akademik, për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Lutemi që brenda 5 ditëve kalendarike nga marrja dijeni për këtë shkresë, të na informoni për masat e ndërmarra, sipas vlerësimit tuaj, lidhur me rishpalljen për herë të tretë të thirrjeve për shprehje interesi nga secili prej institucioneve që ju drejtoni.

Sjellim në vëmendjen tuaj, që gjatë procesit eventual të rishpalljes së thirrjeve, të mbahen parasysh nga ju si organe përgjegjëse të gjitha procedurat, afatet procedurale dhe numri i kandidaturave të parashikuara nga ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Alban BRATI

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

